



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01- 10879/25
Kaçanik, 20.05.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja **V (pestë)** e Rregullt e Komitetit për Komunitete, mbajtur me datë: 20 Maj 2025 (e Martë). Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës Komunale, në sallën e komiteteve të Kuvendit, me fillim pune në ora 11:00.

Pjesëmarrës të këtij takimi nga Komiteti për Komunitete ishin: Lejla Muhaxheri-Çaka-PDK, Arta Avdiu-LVV, Ekrem Livoreka- I Pavarur, Betim Shalë-LDK, Arben Thaqi-OJQ. Nga Ekzekutivi i komunës në takim mori pjesë Suhad Dullovi – Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Mbledhjen e udhëhoqi, kryesuesi i Komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka. Procesmbajtëse Mavije Murseli, Asistente e Kryesuesit të Kuvendit.

z.Ekrem Livoreka: Fillimisht përshëndes të pranishmit, konstatoj kuorumin dhe hapi mbledhjen e V-të (pestë) të rregullt të Komitetit për Komunitete për vitin 2025, data 20 Maj, me këtë :

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Komitetit për Komunitete;
2. Kushtet e bujqëve në Komunën e Kaçanikut;
3. Të ndryshme.

Nëse ka diçka rreth rendit të punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendi i punës u shtrua në votim dhe u votua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Komiteti për Komunitete,

APROVOJ

Rendin e punës, në përbërje prej 3 pikave

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Kryesues i Komitetit, Ekrem Livoreka: A keni ndonjë vërejtje rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?

Nëse jo atëherë, a jeni për miratimin e këtij procesverballi ?

Procesverballi i mbledhjes së IV-të (katërt) të Komitetit për Komunitete i vitit 2025, u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi se Komiteti për Komunitete e,

Aprovoj

Procesverballin e mbledhjes së VI-të (katërt) të Komitetit për Komunitete të vitit 2025, të datës 22.04.2025 / Lënda: 01Nr. 60/01-8275/25.

2. Kushtet e bujqëve në Komunën e Kaçanikut;

z.Ekrem Livoreka: Lidhur me këtë pikë e hapi diskutimin:

z. Suhad Dullovi: Sa i përket Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Kaçanikut kur kam marrë detyrën si drejtor, buxheti fillestar ka qenë 65,000.00 € për subvencione dhe 50,000.00 € për investime kapitale. Falë angazhimit të përgjithshëm të drejtorisë në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët, të cilët kanë qenë shumë aktivë arritëm që në vitin pasues ta rrisim buxhetin ndjeshëm. Vitin e kaluar, buxheti total ishte 130,000.00 €, prej të cilave 60,000.00 € ishin për investime kapitale. Ndërsa këtë vit, kemi 130,000.00 € për subvencione dhe 70,000.00 € për investime kapitale.

Puna dhe përkushtimi ynë kanë bërë që gjatë vitit të kaluar të arrijmë investime në vlerë totale prej 404,395.57 € në sektorin e bujqësisë, duke e tejkaluar kështu premtimin e Kryetarit të Komunës për subvencionet katërvjeçare vetëm për një vit. Kjo arritje nuk përfshin dy vitet e para të mandatit.

Bazuar në kërkesat e fermerëve, kemi qenë të kujdesshëm që t'i përshtatemi sa më shumë nevojave të tyre. Të gjithë fermerët që kanë paraqitur kërkesa të vazhdueshme në drejtori përfshirë bletarinë, serrat, mekanizimin bujqësor, motokultivatorët, frezat, makinat për patate dhe për mbjelljen e misrit janë mbështetur në mënyrë konkrete.

Në këto tri vite, janë realizuar këto shpërndarje: 525 koshere për bletë, 15 centrifuga për mjaltë, 308 sera (brenda dy viteve të fundit), Motokultivatorë në tri faza: një herë 162, pastaj 30 dhe së fundi 86 copë.

Pra, për tri vite me radhë, fermerëve të Kaçanikut u kemi ofruar jo vetëm një arsye për të punuar, por edhe një mundësi reale për të shfrytëzuar në mënyrë efikase tokat që i kanë në emër të vet apo të familjes së tyre.

Kërkesat nga fermerët janë të vazhdueshme, sidomos këtë vit, ku është vërejtur një rritje e dukshme e interesimit për ndërtimin e serave. Kjo për shkak se ato janë duke u shfrytëzuar në mënyrë efektive. Zyrtarët tanë janë në terren në baza të rregullta, duke monitoruar nga afër zbatimin e subvencioneve dhe progresin e fermerëve, që tregon një trend shumë të mirë të punës sonë.

Përveç përkrahjes nga komuna, janë duke u dhënë subvencione edhe nga Ministria e Bujqësisë, gjë që përbën një arritje shumë të mirë. Ekzistojnë subvencione për hektar për kultura të ndryshme bujqësore, si për misër, grurë dhe të tjera.

Drejtoria jonë, vetëm gjatë këtyre tre viteve, ka mbështetur gjithsej 1,100 përfitues, përfshirë sektorët e blegtorisë, bletarisë, pëmtarisë dhe të mekanizimit bujqësor. Kjo përbën një arritje shumë të rëndësishme për Drejtorinë e Bujqësisë në komunën tonë. Një faktor kyç në këto rezultate ka qenë bashkëpunimi i ngushtë me shoqata të ndryshme, përfshirë edhe ato ndërkombëtare. Që nga momenti kur kam marrë detyrën si drejtor, kemi dorëzuar kërkesa konkrete dhe në bazë të punës së bërë, Drejtoria është shpërblyer me mbështetje të prekshme për fermerët.

znj.Arta Avdiu: A ka Komuna ndonjë marrëveshje me Ministrinë e Bujqësisë për projekte të përbashkëta, dhe a kanë të drejtë përfituesit e subvencioneve nga Ministria e Bujqësisë të përfitojnë edhe nga subvencionet që vijnë nga Komuna?

A bashkëpunon Komuna me ndonjë organizatë tjetër joqeveritare ose ndërkombëtare për të mbështetur sektorin e bujqësisë?

A ka ndihmuar komuna për t'u krijuar fermerëve qasje në tregjet lokale dhe rajonale? Gjithashtu, desha të di: a kemi organizuar si komunë ndonjëherë panair bujqësor apo ekspozitë për të promovuar prodhimet vendore të komunës sonë?

z. Suhad Dullovi: Sa i përket pasojave që i kemi pasur si komunë, dua të theksoj se unë personalisht kam dorëzuar disa projekte në Ministrinë e Bujqësisë, por nuk kemi pasur asnjë mbështetje. Për shembull, kam bërë kërkesa që kur sektori i pylltarisë ishte ende nën ombrellën e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. Si drejtor, kam kërkuar që të ndërmerret diçka lidhur me dëmet e shkaktuara në pyje, por nuk kemi pasur asnjë reagim, as nga Ministria e Bujqësisë dhe as nga Ministria e Ambientit, për të pasur një bashkëpunim institucional apo ndonjë veprim konkret.

Po ashtu, kam dërguar një plan konkret në Ministri për të kërkuar ndërhyrje dhe mbështetje për dëmet e mëdha që janë shkaktuar në Parkun Kombëtar “Sharri”, që ndodhet nën kompetencën e tyre. Dëmet në pyje janë të konsiderueshme dhe të pariparueshme për një periudhë afatgjate një lis me diametër 30–50 cm kërkon afërsisht 50 vjet të rritet. Megjithë kërkesat e mia zyrtare me email (të dokumentuara dhe me datë), nuk është ndërmarrë asgjë nga asnjë institucion. Për shembull, një ndër kërkesat është dërguar më 20 maj 2022.

Gjithashtu, kam paraqitur një projekt për ndërtimin e një kanali ujitës me sistem të mbyllur. Kam ftuar kompaninë projektuese në vendin e ngjarjes për të bërë matjet, paramasat dhe projektin përfundimtar. Ky projekt është dorëzuar zyrtarisht edhe deputetit z. Milazim Salijaj dhe ministrit z. Faton Peci, si dhe të gjitha institucioneve kompetente përkatëse. Megjithatë, deri më tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim, dhe nuk kemi marrë asnjë mbështetje për këtë projekt, i cili përfshin një sipërfaqe prej 317 hektarësh që do të mund të ujiteshin me këtë kanal. Vlera e projektit është rreth 209,000.00 €.

Sa i përket mbështetjes për bujqit, Ministria e Bujqësisë ofron vetëm subvencione për pagesa direkte, sipas një rregulloreje që është në fuqi prej vitesh. Gjatë viteve 2023 dhe 2024 nuk kemi pasur asnjë fermer që të ketë përfituar nga subvencionet dhe granteve e ministrisë, ndonëse kemi pasur kërkesa të shumta, veçanërisht për ndërtimin e stallave dhe për lopë. Mungesa e përfitimeve nga kjo ministri është për të ardhur keq, sidomos duke pasur parasysh numrin e bujqve të përkushtuar në komunën tonë.

Në lidhje me shoqatat dhe organizatat ndërkombëtare, unë personalisht kam pasur takime me Shoqatën QATAR, të cilës i kam dërguar disa projekte për serra, mekanizëm bujqësor dhe bletari. Po ashtu, kam pasur takim me organizatën turke TIKa, prej së cilës kemi marrë mbështetje morale dhe premtim për mbështetje të mëtejshme, ndonëse situata globale politike e ka vështirësuar bashkëpunimin.

Gjithashtu, kemi pasur komunikim dhe mbështetje të vazhdueshme nga organizata “Islamic Relief”, të cilët na kanë konfirmuar që do të na mbështesin edhe këtë vit sapo të lirohen fondet nga zyra e tyre në Kanada. Kemi pasur bashkëpunim edhe me organizatën “The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints”, e cila na ka mbështetur me 100 serra gjatë vitit të kaluar dhe jemi në pritje të nënshkrimit të një marrëveshjeje të re për këtë vit.

znj. Arta Avdiu: Sa i përket Komunës, a u ka ndihmuar bujqve për të krijuar qasje në tregjet lokale dhe rajonale? A ka organizuar komuna ndonjëherë panairë apo ekspozita për të promovuar produktet vendore të Komunës sonë?

z. Suhad Dullovi: Sa i përket tregut, ka qenë shumë i mirë për ata fermerë që kanë punuar me përkushtim, duke filluar nga shitja e produkteve si patatat dhe specat çmimet dhe kërkesa kanë qenë të favorshme. Kemi pasur kërkesa edhe nga fermerët që kanë përfituar sera në vitin 2022 dhe pas kultivimit të suksesshëm, kanë shprehur interesim për sera më të mëdha, për shkak se kanë arritur të realizojnë shitje tek familjarët dhe në tregje të vogla lokale. Për këtë arsye, këtë vit kam dorëzuar një kërkesë për ndarje të serave më

të mëdha me sipërfaqe prej 1 ari dhe 2 ari, dhe jemi në pritje të marrëveshjeve të reja me disa shoqata bashkëpunuese, që më pas të shpallim thirrjen për aplikim për fermerët dhe bujqit në përgjithësi.

Sa i përket panairove bujqësore, kemi pasur një propozim nga një shoqatë, por si Drejtori nuk kemi organizuar ndonjë panair deri më tani.

z. Arben Thaçi: Sa i përket përfituesve, po vërehet se shumica janë individë ose kompani që merren me bujqësi dhe si rezultat gjenerojnë vende të reja pune. Edhe pse përfitimi ka shkuar në nivel individual, këto biznese janë të regjistruara si shoqëri dhe funksionojnë në mënyrë të rregullt, duke krijuar vende pune dhe duke realizuar edhe aktivitete si konservimi i frutave dhe prodhimeve të tjera, që janë të domosdoshme dhe kanë nevojë për vazhdimësi.

Sa i plotëson tregu i gjelbër kushtet për ekspozimin e prodhimeve vendore të këtyre bizneseve? Nga ajo që kam parë vetë, më ka rastisur të jem në treg dhe kam vërejtur shumë pak prodhime vendore të ekspozuara. Do të dëshiroja të kishte më shumë, sepse besoj që është bërë një punë e mirë në subvencionim, dhe prodhuesit duhet të kenë më shumë hapësirë për t'i treguar dhe shitur produktet e tyre.

Si drejtori, sa keni kontribuar në lehtësimin e procedurave për fermerët dhe bujqit, duke marrë parasysh që disa prej tyre mund të mos kenë të përfunduar shkollën e mesme dhe mund të mos dinë të aplikojnë vetë? Ka shumë fermerë të mirë që nuk kanë aplikuar asnjëherë, ndonëse janë aktivë në bujqësi. A keni ndërmarrë ndonjë iniciativë për t'i ndihmuar ata në terren, për t'i informuar dhe për t'i asistuar në procesin e aplikimit?

z. Suhad Dullovi: Mbështetja e fermerëve që janë të organizuar si firma nuk është shumë e theksuar në Komunën e Kaçanikut, kryesisht për shkak të sipërfaqes së kufizuar që ka komuna jonë. Megjithatë, interesimi ka ekzistuar edhe para se unë të marrë detyrën si drejtor. Sipas informatave që kam marrë, ka pasur kërkesa. Mirëpo, që nga momenti kur Drejtoria ka ofruar serra më të mëdha, nuk kemi pranuar kërkesa të reja nga fermerët. Në vitin 2023 kemi pasur një subvencionim për fidane (arra dhe kumbulla), për të cilin kemi publikuar njoftim zyrtar. Ka pasur interesim fillestar, veçanërisht për arrat dhe kumbullat, por kur erdhi koha për publikimin e listës së përfituesve, vetëm dy aplikues kishin përmbushur kriteret, dhe më pas edhe ata u tërhoqën. Arsyeja ishte se kishin pritshmëri që Drejtoria e Bujqësisë do të përgatiste dhe rrethonte parcelat për ta edhe për punët teknike, gjë që nuk ishte pjesë e subvencionimit për punët teknike.

Sa i përket trajnimeve dhe lehtësimeve për fermerët, si drejtori kemi organizuar trajnime të rregullta çdo vit zakonisht dy ose tri herë në vit, në të gjitha sektorët. Para dy javësh kemi mbajtur trajnim për blegtorët, ndërsa një muaj më parë kemi zhvilluar trajnim për sektorin e bletarisë. Këto trajnime janë bërë në bashkëpunim me zyrtarin tonë këshillues, z. Mustaf Loku, i cili është i kualifikuar dhe ka ofruar këshilla teknike, si në sallë ashtu edhe në terren. Për më tepër, fermerëve u është ofruar ndihmë edhe gjatë procesit të aplikimit përfshirë edhe mbushjen e formularëve.

Ashtu siç e theksoi edhe Arbeni, ka shumë fermerë të mirë që nuk kanë njohuri të mjaftueshme për të plotësuar aplikacionet, prandaj si drejtori kemi qenë shumë të angazhuar që t'i ndihmojmë dhe t'i përkrahim ata.

Sa i përket tregut të gjelbër, ndonëse nuk i plotëson kushtet 100% si një treg evropian, për nga sipërfaqja dhe hapësira, është i rregullt dhe nuk ka pasur ndonjë ndalesë për fermerët që të dalin dhe të shesin produktet e tyre, qoftë pemë apo perime. Megjithatë, sa i përket furnizimit, situata nuk është ideale kemi shumë pak furnizues të mëdhenj dhe shumica e prodhuesve i shesin produktet e tyre përmes marketeve të vogla. Përveç kësaj, kemi

vetëm një pikë grumbulluese në fshatin Bajnicë, ku disa prej produkteve shkojnë për grumbullim. Ky është realiteti aktual sa i përket tregut dhe furnizimit në komunën tonë.

znj.Arta Avdiu: Sa përqind e popullsisë në komunën e Kaçanikut merret me bujqësi? Drejtoresha e Zhvillimit Ekonomik, znj. Pranvera Loku, ka deklaruar se vetëm rreth 4% e banorëve janë të angazhuar në këtë sektor. A është kjo shifër e saktë? Sa shqetësuese është kjo për komunën dhe çfarë masa ose iniciativa ka ndërmarrë komuna përmes drejtimit të saj, në mënyrë që të ofrojë kushte më të mira dhe të rrisë këtë përqindje?

z. Suhad Dullovi: Sa i përket përqindjes, ne kemi pasur rreth 500 aplikues fermerë që kanë aplikuar në Ministrinë e Bujqësisë për pagesa direkte. Këto pagesa ndryshojnë nga viti në vit, në varësi të benefiteve që fermerët presin, si dhe prodhimtarisë së arritur. Për shembull, në vitin 2023 rendimenti ka qenë rreth 2500 kg për hektar, ndërsa në vitin paraprak ka qenë 4500 kg për hektar. Kjo ndikon drejtpërdrejt në nivelin e subvencioneve dhe interesimin e fermerëve.

Sa i përket çështjes së përqindjes dhe mbështetjes, mund të them me bindje se si Drejtori jemi përpjekur maksimalisht, dhe pikërisht për këtë arsye ka ndodhur që buxheti për subvencione të tejkalohet përtej 100%, pra ka shkuar në 300% të realizimit. Në lidhje me mandatin që unë kam dhe krahasimin me premtimet që ka bërë kryetari, mund të konstatohet se si Drejtori kemi qenë të përkushtuar dhe jemi përpjekur të tejkalojmë pritshmëritë, duke reflektuar angazhimin tonë të vazhdueshëm ndaj fermerëve dhe sektorit të bujqësisë në përgjithësi

z.Ekrem Livoreka: Drejtor, a do të ketë subvencione këtë vit dhe nëse po, për cilat sektorë do të ndahen ato?

z. Suhad Dullovi: Aktualisht, projekti për shkrirjen e dyllit për bletë është në fazën e prokurimit, përkatësisht në procesin e tenderimit. Jemi në bashkëpunim me tri shoqata për marrëveshje të reja për bletarë. Gjatë këtij vitit 2025, do të kemi bashkëpunim me organizatën Islamic Relief, kam përgatitur një projekt që përfshin mekanizimin bujqësor, me theks të veçantë në pajisje që më parë nuk kanë qenë të pranishme në komunën tonë. Ky projekt përfshin: Plugje (të cilat nuk kanë qenë të disponueshme më parë), Makina për mbjelljen e misrit, për të cilat ka pasur kërkesa të vazhdueshme nga fermerët, Kosa rrotative, Freza, Multikultivatorë etj.

Për sa i përket serrave, ka pasur gjithashtu kërkesa të vazhdueshme për mbështetje. Fillimisht, bashkëpunimi me organizatën "The Church of Jesus Christ of Latter-day Saints", e cila ka realizuar projektin e bunarëve nëpër institucione, më ka lënë në dilemë lidhur me përkushtimin e tyre për mbështetjen e sektorit të serrave.

Për këtë arsye, këtë vit kam dorëzuar kërkesa për mbështetje me sera edhe te dy shoqatat e tjera, me shpresën se do të sigurojmë ndihmën e nevojshme për fermerët që janë të interesuar në zhvillimin e prodhimit të mbyllur.

znj.Arta Avdiu: A ofron drejtoria trajnime për fermerët në lidhje me përdorimin e pajisjeve moderne bujqësore, dhe a kryhet monitorim në terren për të siguruar përdorim të drejtë dhe efikas të këtyre pajisjeve?

z. Suhad Dullovi: Po, i trajnojmë fermerët dhe i monitorojmë vazhdimisht në terren. Drejtoria është e angazhuar që gjatë gjithë kohës të ofrojë mbështetje dhe udhëzime praktike për përdorimin e pajisjeve moderne, si dhe të sigurohet që ato të përdoren në mënyrë të duhur dhe efikase.

z. Arben Thaçi: A keni bërë ndonjë analizë të tokës, për shembull si në Rahovec, që kultivon rrush me traditë, ose Mamusha për perimet e gjelbra dhe pemët? A keni bërë analiza të tokës për t'u orientuar si komunë se në çfarë duhet të investohet më shumë si rajon?

z. Suhad Dullovi: Kemi pasur analiza të tilla edhe më herët, për shembull në Kaçanik të Vjetër teorikisht mund të mbilleshin arra, por në praktikë nuk është arritur asnjëherë të funksionojë.

Për momentin, fokusi ynë është te blegtoria, sepse aty ka interes të shtuar dhe potencial zhvillimi. Aktualisht nuk kemi analiza të reja të detajuara për kultura të tjera, por në bazë të të dhënave që kemi, blegtoria mbetet drejtimi më i qëndrueshëm për mbështetje dhe investim.

3. Të ndryshme:

z. Ekrem Livoreka: A keni diçka për të diskutuar në pikën të ndryshme? Nëse jo, atëherë e shpalli mbledhjen të përfunduar, në ora 12:27.

Procesmbajtës
Mavije Murseli



Kryesues i Komitetit
Ekrem Livoreka

